

KADASTRA



Gazetë periodike e Agjencisë Kadastrale të Kosovës



Rilevimi Ajrofotografik i Territorit të Republikës së Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës në kuadër të aktualizimit të të dhënave kadastrale dhe hapësinore si dhe për nevoja të institucioneve tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës siç janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria për Tatim në pronë etj, që prej themelimit të saj ka realizuar 4 (katër) rlevime ajrofotografike në territorin e Republikës së Kosovës.

Një nga produktet kryesore që Agjencia Kadastrale e Kosovës prodhon për palë të ndryhme të interesit, është ortofotografia. Ortofotografia është imazh i sipërfaqes së tokës i krijuar nga ajri përmes ajrofotografimit. Ajrofotografimi i një territori të caktuar është projekt mjaft kompleks, ndërsa për realizimin e një projekti të tillë e të kushtueshëm përfshihen palë të ndryshme profesionale dhe teknologji e avancuar si që janë aeroplanë të pajisur me kamera të rezolucionit të lartë. Për arsye të aktualizimit të të dhënave kadastrale, respektivisht reflektimit të gjendjes së terrenit në hartë ortofotografike, praktikohet që rlevimet ajrofotografike të bëhen çdo tri vite për një territor të caktuar. Ajrofotografimi fillon me përgatitjen e planit të fluturimit, ku territori që do të rlevohet ndahet në blloqe varësisht nga madhësia e territorit si dhe rezolucionit të planifikuar për fotografim. Duke u bazuar në planin e fluturimit fillohet me përgatitjet e terrenit duke vendosur/stabilizuar në terren pikat e kontrollit tokësor të cilat shërbejnë për gjeoreferencimin e imazheve ajrore gjatë prodhimit të ortofotove. Forma dhe madhësia e sinjalizimit të këtyre pikave përcaktohet sipas standardeve për ajrofotografim, ndërsa numri i tyre në terren është varësisht nga madhësia e bllokut të fluturimit. Faza tjetër është fluturimi dhe fotografimi i territorit sipas blloqeve dhe rezolucionit të planifikuar. Me këtë rast fitohet produkti bazë e që janë fotografitë ajrore, ose ortofotot. Fotografit ajrore si produkt bazik futen në një proces të përpunimit me metoda fotogrametrike ku përfitohen produktet tjera si Modeli Digjital i Terrenit.

Aerofotografimet ndër vite

Rilevimi ajrofotografik i bërë në vitin 2001

Rilevimi i parë ajrofotografik nga Agjencia Kadastrale e Kosovës është realizuar në vitin 2001, ku janë fotografuar rreth 80% e territorit të Republikës së Kosovës. Ortofotot janë prodhuar me madhësi 0.5x0.5 km² me rezolucion 20 cm.

Rilevimi ajrofotografik i bërë në vitin 2004

Agjencia Kadastrale e Kosovës në vitin 2004 realizoi rlevimin ajrofotografik, këtë herë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ortofotot e vitit 2004 u prodhuan në 4 (katër) rezolucione:

Rezolucion 15 cm, me madhësi të katrorit 1x1 km² (zonat urbane),
Rezolucion 20 cm, me madhësi të katrorit 1x1 km² (zonat rurale I),
Rezolucion 40 cm, me madhësi të katrorit 2x2 km² (zonat rurale II),
Rezolucion 60 cm, me madhësi të katrorit 5x5 km² (zonat kufitare).

Në vitin 2004 u krijua edhe Modeli Digjital i Terrenit (DTM) me saktësi 5 m, 10 m, 20 m dhe 25 m.

Rilevimi ajrofotografik i bërë në vitin 2009

Rilevimi ajrofotografik i radhës u realizua në vitin 2009, pasi kishin kaluar pesë vite nga rlevimi ajrofotografik i vitit 2004 dhe ndryshimet në terren ishin të mëdha, sidomos në zonat urbane ku ndërtimi kishte marrë hov dhe ndryshimet ndodhnin çdo ditë. pra ishte e nevojshme që të behet rlevimi ajrofotografik në mënyrë që Agjencia Kadastrale e Kosovës të kishte gjendjen aktuale të terrenit.

Ortofotot e vitit 2009 u prodhuan në 3 (tri) rezolucione:

Rezolucion 10 cm, me madhësi të katrorit 1x1 km² (Qyteti i Prizrenit),
Rezolucion 20 cm, me madhësi të katrorit 2x2 km² (zonat urbane),
Rezolucion 40 cm, me madhësi të katrorit 4x4 km² (zonat rurale).

Po ashtu në vitin 2009 u krijua edhe Modeli Digjital i Terrenit (DTM) me saktësi 5 m, 10 m dhe 25 m.

Rilevimi ajrofotografik i bërë në vitin 2012/13

Agjencia Kadastrale e Kosovës për nevoja të aktualizimit të të dhënave, ka realizuar rilevimin ajrofotografik të vitit 2012/13. Rilevimi ajrofotografik i vitit 2012/2013 mbulon të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe është realizuar në 2 (dy) rezolucione. Janë prodhuar ortofoto me rezolucion 8 cm për 26 zona urbane (qytete), kurse i gjithë territori i Republikës së Kosovës është i mbuluar me ortofoto me rezolucion 20 cm.

Aerofotografimi me dron

Me përkrahje të Bankës Botërore, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka implementuar edhe një pilot projekt për aerofotografim me fluturake pa pilot, DRON. Për dallim nga aerofotografimi me aeroplan, Droni përdoret për fotografimin e sipërfaqeve më të vogla, ndërsa fotografitë e bëra nga Droni mund të ndihmojnë në fushën e planifikimit hapësinorë, administrimit të kadastrës, etj.



Ortofoto e prodhuar nga Droni



Aeroplan i modelit Cessna 208 EX Grand Caravan me të cilin do të bëhet aerofotografimi

Rezultatet e Projektit:

Azhurnimi i ortofotove rrjedh si kërkesë e ndryshimeve dinamike dhe zhvillimeve në Republikën e Kosovës në të gjitha fushat, e veçanërisht në fushën e kadastrit dhe pronës. Shumë ndryshime kanë rezultuar nga projektet e implementuara nga vetë Agjencia Kadastrale e Kosovës si rindërtimi i informacioneve kadastrale, krijimi i kadastrit të ndërtesave, regjistrimet sporadike të pronës së paluajtshme, regjistri i unifikuar i adresave, etj. Po ashtu, edhe projekte tjera të realizuara nga institucione të tjera si legalizimin i objekteve, përcaktimin dhe menaxhimin e integruar të vijës kufitare, paraqitja dhe përcaktimi i mbulesës së vegjetacionit që është pjesë e Direktivës së BE, planifikimin urban kanë ndikuar në ndryshime në terren. Si pasojë e ndryshimeve të vazhdueshme që ndodhin në terren, institucionet që merren me hapësirën gjithmonë punojnë që ta kenë gjendjen aktuale

të terrenit në hartat dhe planet e tyre. Pasi që Ajrofotografimi është projekt i kushtueshëm dhe nuk mund të bëhet çdo vit, atëherë është e nevojshme së paku çdo tri vite të bëhen ortofotot e reja për një territor të caktuar në mënyrë që të mund të evidentohen ndryshimet hapësinore të ndodhura në hark specifik kohor. Përndryshe, krijimi i ortofotove është përfshirë edhe në Aneksin II të Direktivës Evropiane INSPIRE si e dhënë që luan një rol të rëndësishëm në paraqitjen e të dhënave të informacionit tematik dhe monitorimin e mjedisit, ndërsa krijimi dhe azhurnimi i kojë pas kohshëm i tyre është obligim për shtetet anëtare të BE-së. Ortofotot e prodhuara nga Agjencia Kadastrale ndër vite mund të gjenden të publikuara dhe të qasshme për secilin person që është i interesuar për to, përmes Gjeoportalit Shtetërorë në adresën <http://geoportal.rks-gov.net>.

AKK me u.d Kryeshef Ekzekutiv të ri

Me vendim të MMPH të datës 9 Korrik, 2018 z. Avni Ahmeti, ish-Drejtor i Drejtorisë për Kadastrë në Ajencinë Kadastrale të Kosovës emrohet në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me të drejta të plota, deri në një vendim tjetër. Pozita e u.d Kryeshefit ka të drejta të plota me ato të Kryeshefit, rrjedhimisht Agjencia Kadastrale e Kosovës do të vazhdojë e papenguar të ushtrorë detyrat e kompetencat e saja konform mandatit për të cilin është e ngarkuar.

Informata mbi AKK

AKK është organ kompetent për kadastrë, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi, për sistem të adresave dhe infrastrukturë të të dhënave gjeohapësinore

Kontakte të rëndësishme

KRYESHEF EKZEKUTIV
Avni Ahmeti
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI LIGJOR
Ismet Kryeziu
Ismet.Kryeziu@rks-gov.net

DREJTORATI I FINANCAVE
DHE ADMINISTRATËS
Fazile Hamiti
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT
Afërdita Thaçi
Afërdita.Thaci@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS
Korab Ahmetaj
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË
Ibadete Rexhepi
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
INFORMATA TË PËRGJITHSHME
akk@rks-gov.net



Zyra kadastrale komunale në Lipjan, pas riinxhinjerimit


Ri-inxhinjerimi i Zyrës Kadastrale Komunale në Vushtrri

Banka Botërore për vite me rradhë kishte mbështetur AKK-në dhe ZKK-të nëpërmjet projektit të Kadastrit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme (RECAP); që kishte për qëllim të ndihmoj zhvillimin e tregut të pronave të paluajtshme dhe të përmirësoj sigurinë e pronësisë në Kosovë. RECAP fokusohet në përmirësimin e administrimit të tokës në nivelin komunal dhe përmirësimin e kapaciteteve të Zyrave Kadastrale Komunale në kryerjen e shërbimeve. RECAP-i kishte mbështetur ri-inxhinjerimin e rreth 20 ZKK-ve, duke financuar renovimin e ndërtesave, orënditë, pajisjet dhe arkivin si dhe realizimin e trajnimeve për stafin e ZKK-ve. Objektivi i ri-inxhinjerimit është që të përmirësohen shërbimet ndaj qytetarëve dhe të përdoret organizimi i ri me zyrë pritëse/operuese dhe procedurat e standardizuara, në mënyrë që transaksionet të jenë më sistematike, efikase dhe transparente. Kjo pasi që bazuar në Ligjin

për Kadastër, Agjencia Kadastrale e Kosovës pos që monitoron aktivitetet profesionale kadastrale që kryhen nga Komunitat, ajo edhe ofron ndihmë profesionale përmes trajnimeve dhe përmes avancimeve teknologjike në këto Zyrë, krejt me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve dhe produkteve kadastrale dhe pronësore. Me përfundimin e projektit RECAP dhe me iniciativë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke parë hapësirat jo të volitshme të punës në të cilat vepronte Zyra Kadastrale Komunale në Vushtrri, me përkrahjen e Autoritetit Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Kartverket" është duke u implementuar ri-inxhinjerimi edhe në Zyrën Kadastrale Komunale në Komunën e Vushtrrisë. Për këtë arsye, Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti, Përfaqësuesi i Autoritetit Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Kartverket" z. Helge Onsrud dhe Kryetari i Komunës së Vushtrrisë z. z. Xhafer

Tahiri kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi për implementimin e këtij projekti. Aktualisht është përgatitur dizajni zbatues arkitektural për ri-inxhinjerimin e ZKK Vushtrri, janë duke u identifikuar nevojat e ZKK në mënyrë që të realizohet ri-inxhinjerimi konform kërkesave dhe specifikave të kësaj Komune, ndërsa si investim llogariten punët renovuese, sistemi i ri i nxehjes, ventilimit, mbrojtjes nga zjarri, arkivën, orënditë, dhe pajisjet e TI, të cilat nevojiten për të siguruar një rrjedhë efikase të punës për stafin e ZKK-së. Po ashtu, AKK do të monitoroj punët që të siguroj se ri-inxhinjerimi i ZKK Vushtrri do të përfundojë me implementimin e zyrave pritëse dhe operuese në përputhje me rregullat dhe direktivat e prokurimit të Bankës Botërore.





Skanimi masiv i dokumenteve pronësore - juridike në Zyrat Kadastrale Komunale

Me qëllim të ngritjes së kualitetit dhe sigurisë së të dhënave pronësore dhe kadastrale, Agjencia Kadastrale e Kosovës është duke implementuar projektin për skanimin dhe indeksimin e të gjithë dokumenteve pronësore dhe kadastrale nëpër zyrat kadastrale komunale

Me qëllim të digjitalizimit dhe indeksimit të dokumenteve pronësoro - juridike nëpër Zyrat Kadastrale Komunale, proces ky i cili do të ndihmonte në integrim e atyre dokumenteve në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), dhe krejt me qëllim të zvogëlimit të kohës së kërkimit dhe përpunimit të dokumenteve kadastrale dhe pronësoro - juridike, Agjencia Kadastrale e Kosovës me përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, si dhe me përkrahjen e donatorëve ndërkombëtar ka implementuar projektin Skanimi Masiv i Dokumenteve Kadastrale dhe pronësoro - juridike. Procesi i skanimit të dokumentacionit kadastral dhe pronësoro - juridik ka filluar në vitin 2015 duke vizituar të gjitha zyrat kadastrale komunale nëpër të cilat është bërë evidentimi i të gjitha dokumentave në letër që kanë qenë pronë e Zyrave Kadastrale Komunale, dhe në bazë të asaj se çfarë është gjetur nëpër ZKK është konstatuar se të gjitha lëndet kanë qenë në formë fizike apo "hard copy". Gjithëashtu nëpër ZKK ka pasur dhe libra të vjetra të të gjitha llojeve të pershkrimit, regjistrimit të matjeve, regjistrimit të pronave dhe të shfrytëzimit të pronave, libra të ndrrimeve, kulturave dhe klasave, ekonomive familjare dhe shumë llojeve të ndryshme Kadastral dhe Gjeodezike të cilat janë shumë të rëndësishme për pronat dhe pronarët e të gjitha Zonave Kadastrale të Kosovës.



Lloji i lëndëve për skanim

Regjistri i Ndrrimeve(Librat)
RDPP për Hipoteka (Librat)
Hipoteka (Lëndët)
RDPP (Lëndët)
RDPP (Librat)
Pasqyra Sumare e Fleteve Poseduese
Bartje te vjetra
Lista e Ekonomive Familjare
Pasqyra ABC e shfrytezuesve (A4)
Regjistri i Fletëparaqitjeve (A4)
Fleta Poseduese
Regjistri i Parcelave
Kadastru Pershkrues
Lista Numerike e Fletave Poseduese
Pasqyra Sipas Kulturave dhe Klaseve (A3)
Dokumentacion Juridik, Kontrata, Lënde nga Gjykata
Formulari i Llogaritjes se Siperfaqeve
Lista Poseduse (Te Vjetra)
Hipoteka (Lëndët)/RDPP (Lëndët)
Kontrata te ndryshme
Fleta Poseduese (Te vjetra)
Operati Kadastral
Lista e Regjistrimit
Komasacion
Fletore Takeometrike
Elaborat Gjeodezik
Pasqyra ABC e Pronareve
Pasqyra e ABC Ekomomive Familjare
Pasqyra Numerike e Fletave Poseduese
Pasqyra sipas Kultutave dhe Klasave (A4)
Regjistri ABC i Pronareve
Regjistri ABC I Shfrytezuesve
Regjistri i Fletëparaqitjeve (A3)
Regjistri i Fletëparaqitjeve (Te vjetra)
Regjistri i llogaritjeve te siperfaqeve
Regjistri i Ndrrimeve
Regjistri i Ndrrimeve (Libra Te vjetra)
Regjistri i Ndrrimeve(Libra)
Regjistri i Numrave te Shtepive
Servitut
Pasqyra ABC e shfrytezuesve (A3)
Pasqyra ABC e shfrytezuesve (A5)
Skicat e Detajit